

Lënda: Kthim përgjigje

Z. Hysen Qeli

Në përgjigje të kërkesës tuaj, drejtuar Institutit të Sigurimeve Shoqërore, të regjistruar me nr. 3700 prot., datë 28.04.2023, ju sqarojmë si më poshtë:

Nga verifikimet e kryera në Drejtorinë e Arkivit Qendror të ISSH-së dhe Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Berat vërtetohet se, z. Hysen Kamber Qeli i datëlindjes 27.07.1954 figuron në rajonin Berat, në Regjistrin Themeltar Nr.7, Faqe Nr.40, të Subjektit “Ndërmarrja Shtetërore Komunale Berat” për periudhën 16.01.1976 - 17.07.1976.

Gjithashtu nga verifikimet e kryera rezulton se, Drejtoria e Arkivit Qendror dhe Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Berat nuk disponojnë regjistra themeltarë të vjetërsisë në punë, bordero apo libra page për Repartin Ushtarak 1371, Palikesh, Berat (brigada e këmbësorisë).

Ndërkohë, për verifikim të mëtejshme të kësaj periudhe vjetërsie ju mund t’i drejtoheni edhe Ministrisë së Mbrojtjes pasi një pjesë e konsiderueshme e dokumentacioni të punësimit të Reparteve Ushtarake (si regjistra pune apo dosje personale të ish punonjësve) administrohet nga Qendrën e Personel Rekrutimit pranë Ministrisë së Mbrojtjes dhe nuk janë dorëzuar në Arkivën Qendrore të Sigurimeve Shoqërore.

Bazuar në nenin 31, të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcaktohet se: *personat e siguruar, që kanë plotësuar jo më pak se 15 vite sigurim shoqëror, kanë të drejtë për pension pleqërie, kur të arrijnë moshën e përcaktuar në nenin 92 të po këtij ligji.*

Ju jeni i datëlindjes 27.07.1954 dhe referuar nenit 92 e drejta për të përfituar pension pleqërie, ju ka lindur në datën 27.07.2019, në moshën 65 vjeç. Nëse plotësoni kushtet e vjetërsisë në punë të kërkuara në ligj, duhet të aplikoni sa më parë, me kërkesën për caktim pensioni pleqërie.

Aplikimi për pension pleqërie, bëhet on-line në portalin e-Albania, tek shërbimi "Aplikim për pension pleqërie, suplementar pilot, suplementar lundruës i nëndetëseve apo suplementar për akademik" në zbatim të neneve 31, 32, 92, 95, të ligjit nr.7703, datë 11.05.1993. Në këtë aplikim duhet të deklaroni saktë të gjitha periudhat e punësimit dhe ndërmarrjet ku keni punuar.

Pas aplikimit, një kopje të aplikimit dhe dokumentat e pensionit si fotokopje e kartës së identitetit, çertifikatë familjare, librezë pune (në rastin konkret duke qenë se nuk e dispononi do të deklaroni që nuk keni), librezë kontributësh, vërtetim për periudhën e shërbimit ushtarak dhe diplomën e shkollës së lartë nëse keni, duhet ti dërgoni nëpërmjet shërbimit postar në adresë të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore të vendbanimit tuaj. Zarfë përcjellës i dokumentave për pension duhet të shoqërohet me numrin e aplikimit.

Strukturat Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, shqyrtojnë dokumentacionin, verifikojnë periudhat e vjetërsisë në punë të deklaruara nga aplikuesi, bëjnë llogaritjet, përcaktojnë masën e pensionit dhe informojnë aplikuesin për veprimet administrative të kryera, konform legjislacionit në fuqi.

Nëse nuk do të jeni dakort me vendimin e përfitimit të pensionit, mund të apelonit kundër vendimit në zbatim të nenit 86, të Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", (i ndryshuar) i cili përcakton se:

1. Apelet kundër vendimeve të përfitimeve bëhen në zyrat rajonale.
 2. Apelet kundër vendimeve të zyrave rajonale bëhen në zyrën qendrore të Institutit të Sigurimeve Shoqërore.
 3. Apelet e zgjedhura në mënyrë të pafavorshme bëhen në gjykatë, nga e cila çështja zgjidhet përfundimisht.
- Bashkëngjitur shkresës sqaruese, gjeni vërtetimet përkatëse (copë 5).

Ju faleminderit për mirëkuptimin.